

## Birësimi në rregullativën e re ligjore

### I. Kuptimi dhe rëndësia shoqërore

Birësimi është institucion i lashtë juridik dhe shoqëror. Trajtat fillestare (në kuptimin sociologjik) i gjejmë qysh para lindjes së shtetit dhe së drejtës.<sup>1</sup> Instituti i birësimit ishte mjaft i shprehur në Romën e lashtë, por ka qenë i njohur edhe në Greqi, Egjipt, Mesopotomi dhe në Babiloni. Duke marrë për bazë aspektin kohor, mund të thuhet se dy kanë qenë qëllimet kryesore të birësimit: në kohën e lashtë qëllim dominues i birësimit të fëmijëve të kushërinjve ose të fëmijëve të proletarëve të varfër ka qenë nevoja e mbrojtjes së pasurisë së qytetarëve të pasur dhe ruajtja e vazhdimësisë së familjes, të traditës dhe të kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë. Për arritjen e këtyre qëllimeve, romakët e vjetër birësuan personat meshkuj madhorë. Pikërisht kjo tregon se birësimi i meshkujve madhorë atëherë nuk bëhej për mbrojtjen e interesave të të birësuarit, por para së gjithash për shfrytëzimin e punës e tij dhe për mbrojtjen e interesave të gjensit, pra të familjes e cila birësonte personat meshkuj madhorë.

Disa vende të botës nuk e njohën asnjëherë birësimin si institut juridik dhe shoqëror. Madje, birësimi ka qenë i ndaluar me norma ligjore.

Në vendet në të cilat u zhvillua ky institut i rëndësishëm ka dominuar qëllimi privat juridik i birësimit, ndonëse

<sup>1</sup> Vojislav Bakić: vepër e cituar, fq., 2.2.

Adrogatio ishte mënyra solemne e birësimit të personave meshkuj madhorë sui juris. Me rastin e aktit të adrogimit, që kryhej para comita calata, i adroguarai hiqte dorë nga familja e tij, nga kulti i tij familjar dhe kalonte si anëtar i familjes së birësuesit. Shih: Ivo Puhani: vepër e cituar, fq., 193.

ka qenë mjaft i shprehur edhe qëllimi i tij shoqëror dhe herë-herë edhe ai politik.

Nuk ka dyshim se birësimi merr rëndësi edhe për birësuesit. Ata në këtë mënyrë plotësojnë dëshirat e veta për të qenë prindër dhe për të pasur fëmijë.<sup>2</sup> Pengesën objektive të quajtur mospasje të fëmijëve, pa të cilët askush nuk ka mundur të bëhej prindër, ata e eliminojnë me rrugë ligjore, duke i birësuar fëmijët e mitur të lindur nga persona të tjerë dhe të mbetur pa përkujdesje prindërore.

Në shekullin e kaluar, ndryshe nga koha e lashtë, qëllim parësor i birësimit bëhet mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon edhe qëllimi i birësimit. Arsyet kryesore qëndrojnë në faktin se, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, një numër tepër i madh i fëmijëve të mitur mbeten bonjakë, pa përkujdesjen e domosdoshme prindërore. Vatra më e ngrohtë për çdo fëmijë është familja. Andaj, vendosja në familje e këtyre fëmijëve, si institucion i pazëvendësueshëm për mirëritjen dhe edukimin e brezit të ri, merr rëndësi edhe për shoqërinë dhe për shtetin. Duke i birësuar këta fëmijë pakësoheshin shpenzimet e shtetit lidhur me sigurimin e përkujdesjes dhe të mirëqenies materiale të fëmijëve të mitur pa përkujdesje prindërore.

Duke pasur parasysh efektet juridike që shkakton birësimi, shkallën e integritetit të të birësuarit në familjen e birësuesit, dallojmë dy lloje të birësimit: a) birësimi i plotë dhe b) birësimi jo i plotë.

**a) Birësimi i plotë (adoptio plena).**- Birësimi i plotë themelohet kur mes birësuesit dhe të birësuarit vendosen marrëdhënie të njëjta sikurse mes prindërve natyrorë dhe fëmijëve, dhe me persona të tjerë si në gjini gjaku. Edhe rregullativa ligjore e përkufizon në mënyrë plotësisht identike apo të ngjashme birësimin e plotë. Kështu, në nenin 169 të LFK-së thuhet: "Birësimi mes palës birësuese dhe të birësuarit themelohen të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve". Këto marrëdhënie janë të pashkëputshme. Birësuesi regjistrohet si prind i të birësuarit (neni 190 i LFK-së), në regjistrin amë të të lindurve. Me atë rast, organi i kujdestarisë mund të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose atij t'i bashkangjesë një apo më shumë emra të tjerë. Ai mund ta bëjë një gjë të tillë vetëm kur konstaton se ajo është në interes të fëmijës. Edhe mbiemrin e të birësuarit, birësuesi mund ta ndryshojë duke i dhënë mbiemër të ri, ashtu që mbiemrit të familjes së origjinës t'i shtojë para ose pas një mbiemër tjetër, nëse edhe kjo shkon në interes të fëmijës. Kur i birësuarit është më i vjetër se 10 vjeç, për çdo ndryshim të mbiemrit kërkohet pëlqimi i tij (neni 195 par. 4 i LFK-së).

<sup>2</sup> Santhipi Begeja: vepra e cituar, fq., 15.

Kjo nënkupton se i birësuar shpesh lidhet me familjen e tij të origjinës. Ai futet në familjen e birësuesit, me të drejta dhe detyrime të plotë sikurse të kishte lindur prej vetë birësuesit. Me birësim të plotë fëmija humb të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj të afërmeve biologjikë: të drejtat familjare, trashëgimore dhe të drejtat e tjera<sup>3</sup>. Mirëpo, në të njëjtën kohë, këto të drejta dhe detyrime i fiton ndaj birësuesit dhe të afërmeve të tij biologjikë.

**b) Adoptimi jo i plotë (adoptio semi plena).**- Me birësim jo të plotë duhet kuptuar vendosjen e marrëdhënieve prindërore vetëm mes birësuesit dhe fëmijës që birësohet, si dhe pasardhësve të fëmijës, mirëpo janë të mundshme kufizimet në pikëpamje të të drejtave përkitazi me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore.<sup>4</sup> Te birësimi jo i plotë fëmija paraqitet subjekt i marrëdhënieve të reja prindërore, megjithëse edhe më tej mbetet anëtar i familjes së vet biologjike<sup>5</sup>. Në fakt, ai gëzon edhe më tej të drejtën trashëgimore dhe të mbajtjes ndaj prindërve të vet biologjikë. Këtu nuk kemi të bëjmë me vendosjen e marrëdhënieve gjinore sikurse gjinia e gjakut mes fëmijës dhe personave gjini të birësuesit. Sepse, kjo marrëdhënie krijohet vetëm në krahun zbritës - mes birësuesit dhe të paslindurve të fëmijës së birësuar. Kjo nënkupton se birësuesi, edhe pas birësimit, ruan marrëdhëniet gjinore me familjen e origjinës dhe me persona të tjerë të gjinisë së gjakut. Birësimi jo i plotë është i shkëputshëm. Pas shkëputjes, sipas rregullës, fëmija u kthehet prindërve biologjikë. Në literaturën juridike hasen edhe terma të tjerë, të cilët përkufizojnë këtë institucion juridik, si - birësimi i thjeshtë apo edhe i rëndomtë.

**1.1. Kush mund të jetë i birësuar.**- Që një person të jetë i birësuar, duhet t'i plotësojë këto kushte: a) të jetë i lindur gjallë, b) të jetë fëmijë i mitur, c) të mos jetë në gjini gjaku me birësuesin.

a) **Që fëmija të jetë i lindur gjallë.**- Vetëm fëmija i lindur gjallë mund të birësohet. Nuk mund të ketë themelim të birësimit pas vdekjes së fëmijës (neni 191 të LFK-së). Po ashtu, qëllimi i birësimit është vendosja e fëmijës në familjen e birësuesit në përkujdesje, në mirëritje dhe në edukim. Nëse fëmija nuk ka lindur, atëherë nuk mund të arrihet qëllimi i birësimit. Madje, me dispozitat ligjore të LFK-së është paraparë një periudhë provuese tremujore brenda së cilës duhet të provohet nëse mundet

<sup>3</sup> Marina Janjić-Komar dr Radoje Korać dr Zoran Ponjavić: vepra e cituar, faqe,247.

Ligji i familjes i Kosovës sikurse edhe Kodi i familjes i Shqipërisë nuk rregullojnë birësimin jo të plotë. Ndryshe nga këto dy akte ligje, Ligji i familjes i Maqedonisë e rregullon edhe birësimin jo të plotë në nenin 115.

<sup>4</sup> Po aty, faqe,243.

<sup>5</sup> Po aty, faqe, 247.

apo nuk mundet të arrihet qëllimi i birësimit. Nëse konstatohet gjatë kësaj periudhe se mund të arrihet qëllimi i birësimit, vetëm atëherë mund të lidhet birësimi.

Në qoftë se, edhe pas kalimit të këtij afati provues nuk mund të vërtetohet saktësisht se a do të mund të arrihet qëllimi i adaptimit, ky afat do të mund të vazhdohet edhe për tre muaj të tjerë.

Në bazë të kësaj, konkludohet se ligjvënësi kosovar ka pasur parasysh faktin se mund të birësohet vetëm fëmija i lindur gjallë, e jo edhe fëmija i cili nuk ka lindur i gjallë. Sepse, pas vdekjes së fëmijës qëllimi i birësimit nuk mund të arrihet.

Disa vende kanë paraparë se fëmija mund të birësohet vetëm pasi që të ketë mbushur moshën e caktuar me ligj. P.sh.: Britania e Madhe ka paraparë se fëmija mund të birësohet vetëm pasi që të ketë mbushur 6 muaj të jetës, Çekosllovakia – një vit. Këtu është fjala vetëm për birësim të plotë, pra, të pashkëputshëm.

**b) Të jetë fëmijë i mitur.-** Kusht tjetër relevant për lidhjen e plotfuqishme të birësimit është që fëmija i cili birësohet të jetë i mitur, sepse vetëm ai mund t'i përshtatet shpejtë ambientit të ri familjar dhe prindërve të rinj. LFK-ja me nenin 167, po ashtu edhe KFSH-ja, me nenin 241, kanë paraparë se mund të birësohet vetëm fëmija i mitur, domethënë se në asnjë mënyrë nuk lejohet të birësohet personi që ka mbushur moshën madhore. Instituti i birësimit synon të mbrohen në radhë të parë interesat e fëmijëve të mitur, që janë pa prindër ose pa kujdesin prindëror, me qëllim që atyre t'u sigurohet një atmosferë sa më e ngrohtë familjare dhe kushte sa më të mira për rritje dhe edukim.<sup>6</sup>

<sup>6</sup> Santhipi Begeja: vepra e cituar, faqe, 189.

Disa shtete, ndërkaq lejojnë zotësinë pasive për të qenë i birësuar edhe fëmijës së palindur (nosciturus-it). Shih: Bakiq, faqe 277. Ligji për familjen i Kosovës përdor termin tekniko-juridik adoptim për institutin e birësimit. Shih: Nenet 161-2003. Kodi i familjes i Shqipërisë shërbehet me termin teknik juridiko-birësim kur është fjala për individualizimin e këtij instituti juridik (neni 240-262). Sipas Begeës, fjala adoptio vjen nga latinishtja. Ad optio do të thotë me zgjedhë. Familja antike romake formohej nga personat që ishin gjini dhe quheshin konjati dhe nga personat që zgjidhte kryetari i familjes dhe që bënin pjesë në familje si anëtar. Kjo zgjedhje quhej adoptio. Shih: Begeja, faqe 137. Ndërkaq, disa të tjerë mendojnë pak më ndryshe. Me fjalën latine adoptio, duhet kuptuar pranimin për të vetin, birësimin. Shih: Milan Vujaklia: "Leksikon stranih reči i izraza", faqe, 13.

Si do që të jetë, ne mendojmë se termi tekniko - juridik birësimi po përdoret gjithnjë e më shpesh në vend të termit adoptim në legjislacionin shqiptar dhe në të folmen shqipe. Pasiqë është i fjalorit të gjuhës shqipe, dhe më i saktë juridikisht, mendojmë se është më e drejtë që ta përdorim shprehjen shqipe birësim, e jo atë latine adoptio, edhe për shkak të pastërtisë së gjuhës dhe lirimin e shqipe nga shprehjet dhe fjalët e huaja aty ku i kemi tonat.

c) **Mosqenia në gjini të gjakut.**- Nuk mund të birësohet fëmija i mitur që është në gjini gjaku me birësuesin. Ky ndalim vlen për personat në gjini gjaku, pavarësisht nga shkalla, pra për të gjithë të paralindurit dhe të paslindurit. Po ashtu, nuk mund të birësojnë as vëllai as motra vëllain apo motrën e vet. Kjo do të thotë se birësimi është i ndaluar edhe mes personave gjini gjaku në vijë të tërthortë, deri në shkallë të dytë. Nuk mund të birësohet një person nga të paralindurit e tij, si dhe vëllai nga motra, dhe anasjelltas (neni 243 i LFSH-së). Një ndalim të tillë e ka paraparë gjithashtu edhe neni 179 par. 1 i LFK-së. Ndërkaq, me par. 2 të po këtij neni, LFK-ja ka paraparë se “kujdestari nuk mund ta birësojë të kujdesuarin e vet, përderisa organi kompetent të mos e shkarkojë nga detyra e kujdestarit”. Kjo do të thotë se ndalimi i birësimit shtrihet edhe mbi kujdestarin dhe të kujdesuarin. Në teorinë juridike, duke marrë parasysh qëllimin që duhet të arrihet përmes birësimit (mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur), konstatohet se nuk mund të birësohet as i mituri që nuk ka mbushur moshën 18 -vjeçare, nëse ka lidhur martesë.<sup>7</sup>

ç) **Pëlqimi i fëmijës.**- Fëmija duhet ta japë pëlqimin nëse dëshiron të birësohet. Sipas legjislacionit kosovar, fëmija ka detyrë ta japë pëlqimin vetëm nëse ka mbushur 14 vjet. Fëmija i moshës më të re nuk ka detyrë të japë këtë pëlqim, sepse konsiderohet se nuk është në gjendje për ta kuptuar rëndësinë e dhënies së pëlqimit. Pëlqimin për fëmijën me paaftësi për të vepruar, ose që është më i ri se 14 vjet, mund ta japë vetëm përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht kujdestari i të birësuarit (neni 170 i LFK-së). Do theksuar se disa legjislacione kanë paraparë që pëlqimin për birësim duhet ta japin edhe fëmijët e moshës më të re – 10 vjet.

d) **Kush mund të jetë birësues.**- Edhe birësuesi duhet t'i plotësojë kushtet e parapara ligjore për të birësuar fëmijën që është i mitur. Birësuesi duhet t'i plotësojë këto kushte të nevojshme të përcaktuara me dispozita ligjore: 1) birësuesi duhet të ketë zotësinë për të vepruar; 2) të ketë cilësitë personale të nevojshme për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe të jetë i aftë për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve; 3) të mos vuajë nga sëmundje ngjithëse që do të rrezikonin shëndetin e fëmijës; 4) të ketë mbushur moshën 21- vjeçare.

<sup>7</sup> Mira Alinčić Ana Bakarić-Mihanović, vepër e cituar, faqe, 232.

Sipas nenit 157 të LFK-së mund të birësohet fëmijët pa kujdes prindëror. Fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilëve janë të panjohur ose janë të zhdukur. Fëmija pa kujdesin prindëror është edhe fëmija prindërit e të cilit për çfarëdo arsye në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyra prindërore ose kujdesin prindëror. Shih: neni 157 i LFK-së.

Fëmijën e mitur mund ta birësojnë edhe bashkëshortët. Kur bashkëshortët e birësojnë fëmijën, njëri prej bashkëshortëve duhet ta ketë mbushur moshën 25- vjeçare, ndërsa bashkëshorti tjetër moshën 21- vjeçare (neni 178 i LFK-së). Nëse fëmijën e birëson vetëm njëri nga bashkëshortët, kërkohet pëlqimi edhe i bashkëshortit tjetër. Mirëpo, mund të ndodhë që njëri bashkëshort ta birësojë fëmijën e bashkëshortit tjetër. Në këtë rast fëmija i birësuar fiton statusin e fëmijës së përbashkët të bashkëshortëve. Kjo do të thotë se ata ushtrojnë njëjtë të drejtat prindërore kundrejt fëmijës të birësuar.

Po ashtu, është e nevojshme që të ekzistojë ndryshimi në moshë mes birësuesit dhe të birësuarit (*adoptio naturum imitatur*), sepse me birësim krijohen po ato marrëdhënie që krijohen mes prindërve dhe fëmijëve. Nga ky aspekt, birësimi i një mashkulli të moshës 18- vjeçare me një të mitur 17-vjeçare pa mëdyshje do të ishte alogjik dhe i panatyrshëm. Sepse, diferenca në moshë mes prindërve dhe fëmijëve rrjedhimisht është dukshëm më e madhe.

Diferenca tepër e madhe në moshë mes birësuesit dhe të birësuarit po ashtu nuk është e lejueshme. Në raste të tilla, as praktika gjyqësore nuk ka pranuar lidhjen e birësimit, sepse ndryshimi i theksuar i moshës pengon qëllimin e vërtetë që synon birësimi.<sup>8</sup> Nga personi i shtyrë në pleqëri të thellë është reale të pritët që ai nuk do të jetë në gjendje të përkujdeset për veten e tij, e lëre më për fëmijën e mitur. Birësimi bëhet në interes të fëmijëve të mitur. Nga ky shkak, birësues mund të jetë vetëm personi i cili ka cilësi të nevojshme për realizimin e qëllimit të birësimit.

**dh) Pëlqimi i prindërve.**- Sipas dispozitave ligjore, kur fëmija i mitur i ka gjallë të dy prindërit, ose njërin prej tyre, kërkohet pëlqimi i tyre për birësimin e fëmijës. Dhënia e pëlqimit ka rëndësinë e heqjes dorë nga të drejtat prindërore.<sup>9</sup> Megjithëse dhënia e pëlqimit krijon efekte relevante juridike, natyra juridike e tij nuk është studiuar sa duhet. Madje, janë paraparë raste kur birësimi mund të lidhet edhe pa pëlqimin e prindërve të fëmijës së mitur që birësohet. Kështu, nuk kërkohet pëlqimi nëse prindit me vendim të gjykatës i është hequr zotësia për të vepruar, nëse nuk i dihet për më shumë se një vit vendbanimin (neni 171 i LFK-së).

Kur është fjala për heqjen e zotësisë për të vepruar, situata është e qartë, se këtu kemi të bëjmë me një fakt juridik; për shkak të humbjes së zotësisë së veprimit, prindërit nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat dhe detyrat prindërore. Ata nuk do jenë në gjendje të kujdesen as për fëmijët e tyre e as për fëmijët e lindur nga personat e tjerë. Fëmijët gëzojnë mbrojtje

<sup>8</sup> Santhipi Begeja: vepra e cituar, faqe, 191.

<sup>9</sup> Marina Janjić-Komar dr Radoje Korać dr Zoran Ponjavić: vepra e cituar, faqe, 244.

të veçantë shoqërore, ndërsa instituti i birësimit para së gjithash është në funksion të mbrojtjes së interesave të fëmijëve të mitur dhe pa përkujdesje prindërore. Nga ana tjetër, kur është fjala për braktisje të fëmijës dhe lënie të tij pa përkujdesje prindërore, ligjvënësi ka përcaktuar afatin kohor prej një viti për kthimin e prindit dhe për dhënien e pëlqimit për birësim. Nëse brenda këtij viti prindi nuk kthehet dhe nuk e jep pëlqimin për birësim, birësimi mund të bëhet edhe pa pëlqimin e tij, sepse çdo pritje më e gjatë do të cenonte edhe ashtu të cenuara interesat e fëmijës. Sipas nenit 248 të KFSH-së: "Prindërit mund të tërheqin pëlqimin e tyre edhe pas kalimit të afatit tremujor deri në çastin e marrjes së vendimit nga gjykata kompetente".

1.2. **Natyra juridike.**- Një kohë të gjatë, si në literaturën juridike, ashtu edhe në rregullativën ligjore, është përkrahur qëndrimi se birësimi është një kontratë formale familjare juridike. Me kontratë janë bartur të drejtat dhe detyrat nga prindërit në personin i cili ka birësuar fëmijën e mitur. Autorët që përkrahen pikëpamjen se birësimi është kontratë u bazuan në argumentin se me rastin e birësimit kërkohet si prezenca e birësuesit, e fëmijës që birësohet, nëse është i moshës që kërkohet me norma ligjore, ashtu edhe e përfaqësuesve të tij ligjorë. Shprehja e vullnetit bëhet me dhënien e pëlqimit për birësim. Ky vullnet, sipas teorisë juridike, përbën elementin më qenësor të kontratës. Në bazë të kësaj, birësimi është quajtur kontratë formale familjare juridike.

Mbrojtja e interesave të fëmijës pa përkujdesje prindërore tani ka dalë në plan të parë. Kriteri i mbrojtjes së interesave të fëmijëve ka ndikuar në natyrën juridike të birësimit në kuptimin që vendimi i organit administrativ e zëvendëson kontratën dhe mundëson që vendosja e fatit të fëmijëve të kalojë prej prindërve, në autorizime të nëpunësve zyrtarë<sup>10</sup>. Duke marrë për bazë natyrën e marrëdhënieve që lindin me birësim, thelbi i birësimit nuk konceptohet tani në kontratë, megjithëse pashmangshëm përmban elemente të saj, veçse në natyrën e së drejtës pozitive që aplikohet, si kur është fjala për kushtet, ashtu edhe për vendimin e birësimit. Edhe kjo flet se marrëdhëniet prindërore që krijohen mes birësuesit dhe të birësuarit nuk themelohen me lindje, sikurse është rasti mes prindërve biologjikë dhe fëmijëve, veçse artificialisht, me rrugë ligjore.

## II. Themelimi i birësimit

Themelimi i birësimit është një akt juridik. Ai themelohet përpara organit të kujdestarisë. Kompetencat tokësore për lidhjen e tij caktohen në

<sup>10</sup> Po aty, faqe, 245.

bazë të vendbanimit të birësuesit. Kur nuk dihet vendbanimi, atëherë në bazë të vendqëndrimit të tij të fundit. Me dispozitën e nenit 183 par. 1 dhe 2 të LFK-së është paraparë që për themelimin e birësimit është kompetent, në pikëpamje të kompetencës tokësore, organi i kujdestarisë, në juridiksionin e të cilit personat që kërkojnë të birësojnë e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Apo, kur ky vendbanim nuk dihet, atëherë kompetent është organi i kujdestarisë ku i birësuarit ka pasur vendqëndrimin e fundit. Mirëpo, duhet të thuhet se as LFK-ja, as KFSH-ja nuk kanë paraparë vendqëndrimin e fundit si kriter për caktimin e kompetencës tokësore të organit të kujdestarisë përkitazi me lidhjen e birësimit, madje edhe në rastet kur nuk dihet vendbanimi i të birësuarit, me gjithë faktin se kriterin për caktimin e kompetencës tokësore e kanë paraparë shumë ligje të familjes të vendeve të tjera.

Në procedurën e birësimit përjashtohet publiku. Përjashtimi i publikut nga seanca bëhet për mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur që birësohen dhe për ruajtjen e fshehtësisë. Procesverbali dhe dokumentet e themelimit të birësimit paraqesin sekret zyrtar.<sup>11</sup> Procedura e birësimit fillon me kërkesën për birësim. Personi i cili kërkon të birësojë, së bashku me prindërit e fëmijës së mitur që do të birësohet, kërkesën duhet t'ia parashtrojnë organit të kujdestarisë. Asaj duhet bashkangjitur pëlqimin e shkruar të prindërve biologjikë të fëmijës, certifikatën e lindjes të fëmijës dhe dokumentet e tjera relevante, si dëshmi se ekzistojnë kushtet për mirërritjen e ardhshme të fëmijës, informatat për të birësuarin dhe birësuesin, si dhe kushtet e birësimit (neni 184 par 2 i LFK-së). Po kësaj kërkesë i duhet bashkangjitur edhe prova të tjera, në bazë të të cilave provohet se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e birësimit.

Organi i kujdestarisë në rend të parë duhet të vërtetojë nëse personi që kërkon të birësojë dhe fëmija i mitur që do të birësohet janë persona të përshtatshëm për birësim.<sup>12</sup> Në bazë të normave ligjore lidhur me vlerësimin e rrethanave të cilat diktojnë përshtatshmërinë dhe suksesin e birësimit, si cilësitë e birësuesit, motivet e birësimit, lidhjen emotive të fëmijës me prindër, shkaqet për të cilat prindërit japin pëlqimin për birësimin e fëmijës të tyre, etj., organi i kujdestarisë duhet të marrë mendimet dhe konstatimet e ekspertëve të fushave të caktuara: sociologut, psikologut, mjekut, defektologut, juristit dhe të ekspertëve tjerë të nevojshëm.

<sup>11</sup> Po aty, faqe, 246.

Sipas nenit 97 të LFM-së birësimi themelohet përpara qendrës për punë sociale. Mirëpo, sipas nenit 254 të KFSH-së, organ kompetent para të cilit duhet të lidhet birësimi është gjykata e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë.

<sup>12</sup> Mira Alinčić Ana Bakarić-Mihanović, vepër e cituar, faqe, 237.

Kjo nënkupton se organi i kujdestarisë duhet në mënyrë të plotë të hetojë nëse janë plotësuar kushtet dhe nëse birësimi mund të jetë i suksesshëm para se të marrë vendim.

Në kontest të kësaj, është paraparë me dispozita ligjore periudha provuese. Vendosja e fëmijës në familjen e personit që kërkon ta birësojë është prova më e saktë që mund të dëshmojë nëse një fëmijë mund të adaptohet me ambientin në familjen e re, apo jo. Prandaj, kjo formë e të provuarit merr një rëndësi të madhe para lidhjes së birësimit. Birësimi mund të jetë i plotfuqishëm vetëm nëse është lidhur në formën e paraparë me dispozita ligjore.

Kur plotësohen kushtet e parapara për birësim, organi i kujdestarisë do të konstatojë themelimin e birësimit me vendim. Akti i themelimit është solemn, me ç'rast nevojitet prania e birësuesit, e prindërve apo kujdestarit të të birësuarit, në rastet kur prindërit mungojnë për shkak se kanë vdekur, si dhe prania e vetë të birësuarit, nëse është më i vjetër se 10 vjet. Lidhur me birësimin mbahet procesverbal i veçantë. Ky procesverbal duhet të përmbajë të dhënat për birësuesin dhe të birësuarin, për mbiemrin e të birësuarit dhe për emrin, nëse me rastin e birësimit i është ndryshuar. Organi i kujdestarisë ka për detyrë t'i mbajë të gjitha shënimet dhe t'i ruajë dokumentet për personin e birësuar dhe procesin e birësimit (neni 189 par 6 i LFK-së). Ky procesverbal i dërgohet menjëherë ofiqarit për të regjistruar birësimin në librat amë të të lindurve. Birësuesi regjistrohët si prind i të birësuarit. Normat ligjore të cilat zbatohen me rastin e birësimit janë të natyrës administrative. Pas themelimit të birësimit, ai më nuk mund të revokohet as të vërtetohet prejardhja e fëmijës.<sup>13</sup>

**1.3. Birësimi i fëmijës nga një shtetas i huaj.-** Si rregull, birësues mund të jetë vetëm personi me shtetësi kosovare. Një gjë e tillë parashihet me dispozitat ligjore, para së gjithash për mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Fëmijët shumë më shpejt do të ambientohen në familje shqiptare ku flitet gjuha amtare, sesa në një ambient tjetër në të cilin ekziston një ekskomunikim me anëtarët e familjes së birësuesit.

Por, rregulla e përmendur ka edhe përjashtimet e veta. Përjashtimisht, birësuesi mund të jetë edhe shtetas i huaj nëse për një gjë të tillë

<sup>13</sup> Mira Alinčić Ana Bakarić-Mihanović, vepër e cituar, faqe 248

Kushtet dhe efektet e birësimit të shpallur në Shqipëri përcaktohen nga legjislacioni shqiptar. Birësimi ndërvendas nuk lejohet kurrë: a) birësimi nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit; b) arrihet në përfundimin se birësimi është me pasoja të rënda për të miturin; c) i mituri, në shtetin ku banon birësuesi nuk gëzon të njëjtat të drejta që njihen në Shqipëri. Birësimi ndërvendas lejohet pasi fëmija ka qenë në pritje për gjashtë muaj në listat e Komitetit shqiptar të birësimit dhe gjatë kësaj periudhe janë ezauruar të gjitha mundësitë për të bërë birësimin brenda vendit. Shih nenin 257 të KFSH-së.

ekzistojnë shkaqet posaçërisht të arsyeshme (neni 181 i LFK-së). Ndërkaq, sipas nenit 181 par. 3 të po këtij ligji, për birësimin e fëmijës nga shtetasi i huaj nevojitet pëlqimi paraprak nga organi administrativ, kompetent për punët e politikës sociale.

Edhe Kodi i familjes i Shqipërisë lejon birësimin e të miturit shqiptar nga persona me shtetësi të huaj. Mirëpo, mund të thuhet se legjislacioni shqiptar po ashtu bën përkufizime. Kështu, sipas dispozitës së nenit 252 të KFSH-së, “nga shtetasit e huaj mund të birësohen vetëm të miturit të cilët figurojnë në listën e Komitetit shqiptar të birësimit”. Kërkesën për birësimin e fëmijës së mitur shtetasi i huaj nuk ia paraqet drejtpërdrejt Komitetit shqiptar të birësimit, por ajo shkon “nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizatave private të parashikuara me ligj”. Pas shqyrtimit të kërkesës e të dokumentacionit përkatës, Komiteti shqiptar i birësimit i dërgon gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë, si dhe atë të të miturit që kërkohet të birësohet.

As Ligji i familjes i Kosovës, as Kodi i familjes i Shqipërisë nuk përmbajnë norma konkrete ligjore, me të cilat u ndalohe shtetasve kosovarë apo shqiptarë birësimi i fëmijëve me shtetësi të huaj.

**1.4. Refuzimi i birësimit.**- Kur organi i kujdestarisë, pas çmuarjes së të gjitha rrethanave, gjen se birësimi do të jetë i dëmshëm për birësuesin, apo se me birësim do të dëmtoheshin interesat e fëmijës që birësohet, ai me vendim do të refuzojë kërkesën për birësim. Posaçërisht do ta refuzojë kërkesën kur gjen se në një rast konkret nuk mund të arrihet qëllimi i birësimit. Kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për birësim mund të ushtrohet ankesë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit (neni 187 i LFK-së).

**1.5. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve biologjikë.**- Pas themelimit të birësimit, prindërit biologjikë nuk mund t'i ushtrojnë më të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve të tyre, edhe nëse ata janë gjallë. Në teorinë juridike konsiderohet se me themelimin e birësimit, të drejtat dhe detyrimet e prindërve mbarojnë (nudum ius). Këto të drejta dhe detyrime i kryen birësuesi në vend të prindërve, sepse e drejta pozitive, siç është parë më lart, përkrah pikëpamjen që më birësim themelohen marrëdhëniet prindërore mes birësuesit dhe të birësuarit. Mirëpo, vetvetiu shtrohet pyetja a do t'u kthehen të drejtat dhe detyrimet prindërore prindërve biologjikë të fëmijëve dhe a do t'u mundësohet që t'i ushtrojnë ato edhe pas pushimit të birësimit. Ç'është e vërteta, në teorinë e vjetër juridike ka mbizotëruar mendimi se me pushimin e birësimit, në mënyrë automatike

shkaktohet rivendosja e të drejtave dhe detyrimeve me prindërit biologjikë, pa vendim të asnjë organi kompetent.<sup>14</sup>

Edhe pikëpamjet në teorinë e re juridike dhe në rregullativën ligjore nuk dallojnë shumë nga të parat. Kjo vlen sidomos kur është fjala për anulimin e birësimit dhe heqjen e së drejtës prindërore të birësuesit. Nëse prindi biologjik nuk është i pajtimit që të marrë përsipër kujdesin dhe rritjen e fëmijës, organi i kujdestarisë ka për detyrë që të kujdeset për mirëqenien e fëmijës.

Në këtë rast, organi i kujdestarisë do të ketë parasysh posaçërisht mbrojtjen e interesave të fëmijës, kushtet e mirërritjes dhe të zhvillimit normal fizik dhe psikik të tij. Mirëpo, këtu duhet të thuhet se problemin e ndërlikon çështja se birësimi i plotë është i pashkëputshëm. Mosshkëputja e këtij lloj birësimi do ta bëjë të pamundur kthimin e serishëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore të prindërve biologjikë. Megjithatë, ky qëndrim del i paqëndrueshëm, sepse nëse birësimi i plotë nuk mund të shkëputet, ai mund të anulohet dhe në këtë mënyrë prindërve biologjikë u kthehen përsëri të drejtat dhe detyrimet. Birësimi i plotë anulohet nëse me rastin e themelimit të birësimit nuk kanë qenë të plotësuar kushtet e kërkuara ligjore për lidhjen plotfuqishme të birësimit të plotë.

**1.6. Shuarja e birësimit.**- Në të drejtën pozitive mund të zgjidhet vetëm birësimi jo i plotë me vendim të organit të kujdestarisë, kur vërtetohet se ekzistojnë shkaqet e arsyeshme, në bazë të kërkesës së birësuesit apo të të birësuarit, nëse këtë e kërkojnë shkaqet e arsyeshme edhe në bazë të marrëveshjes së tyre.<sup>15</sup> Pos dy mënyrave të përmendura, birësimi jo i plotë mund të shuhet edhe me zgjidhje sipas detyrës zyrtare dhe me lidhje të martesës. Me vdekjen e birësuesit nuk shuhet birësimi, por vetëm të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhëniet prindërore.<sup>16</sup>

Ndërkaq, mund të thuhet se zgjidhja e birësimit jo të plotë me marrëveshje është mënyra më e shpeshtë e zgjidhjes së tij. Kjo ndodh sidomos kur i birësuarit mbush moshën madhore dhe pushon nevoja për përkujdesje, mirërritje dhe edukim ndaj tij. Nëse birësimi jo i plotë zgjidhet para se i birësuarit të ketë mbushur moshën madhore, të birësuarin e përfaqësojnë prindërit. Në qoftë se prindërit i kanë vdekur, atëherë e përfaqëson organi i kujdestarisë. Organi i kujdestarisë në çdo rast është i detyruar të hetojë në është zgjidhja e birësimit në interes të birësuarit, nëse birësimi zgjidhet kur fëmija është i mitur.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Marina Janjić-Komar dr Radoje Korać dr Zoran Ponjavić: vepra e cituar, faqe,247.

<sup>15</sup> Po aty, faqe, 248.

<sup>16</sup> Po aty, faqe, 248.

<sup>17</sup> Vojislav Bakić: vepër e cituar, fq., 28.

Ndonëse me norma ligjore nuk e ka rregulluar shprehimisht birësimin jo të plotë, në nenin 200 LFK-ja ka paraparë shuarjen e birësimit ex officio. Me paragrafin 3 të nenit 200 të po këtij ligji është paraparë se "marrëdhëniet e birësimit mund të shuhen vetëm në qoftë se prindi biologjik është i pajtimit të marrë përsipër kujdesin dhe rritjen e fëmijës dhe nëse ushtrimi i kujdesit nga ai nuk do të ishte në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës". Po sipas dispozitës së nenit 200 par. 3, nënpar. 2, shuarja e birësimit do të bëhej edhe nëse, me shuarjen e birësimit të vjetër, do të mundësohet lidhja e një birësimi të ri. Sakaq, doktrina juridike mendon se zgjidhja e birësimit jo të plotë, sipas detyrës zyrtare, mund të bëhet kur një gjë të tillë e kërkojnë interesat e arsyeshme të fëmijës së mitur të birësuar. Bie fjala, kur birësuesi i lë pas dore interesat e të birësuarit, e keqpërdor pozitën, duke e nxitur të birësuarin të kryejë vepra penale, ose e edukon në kundërshtim me normat etike dhe të mirësjelljes. Pas shuarjes së birësimit nuk shuhet e drejta e trashëgimisë testamentare.

Shuarja e birësimit jo të plotë, sipas teorisë juridike, bëhet edhe kur mes birësuesit dhe të birësuarit lidhet martesë. Me lidhjen e martesës mes birësuesit dhe të birësuarit zgjidhet martesë.<sup>18</sup> Kjo është krejtësisht e kuptueshme, sepse në të njëjtën kohë nuk mund të koekzistojnë marrëdhëniet martesore dhe ato prindërore.<sup>19</sup> Zgjidhja e birësimit jo të plotë bëhet para së gjithash për ta ruajtur martesën, në njërin anë, kurse, nga ana tjetër, për shkak se ajo paraqet ndalesë për lidhjen e martesës. Zgjidhja e birësimit jo të plotë duhet të bëhet me vendim të organit të kujdestarisë. Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Por, është me rëndësi të theksohet se as LFK-ja as KFSH-ja me norma ligjore nuk e kanë rregulluar as afatin e ankesës, as mënyrën e zgjidhjes së birësimit jo të plotë.

**1.7. Pasojat e zgjidhjes së birësimit.**- As Ligji i familjes i Kosovës, as KLSH-ja nuk i rregullojnë hollësisht pasojat e zgjidhjes së birësimit jo të plotë. Vihet në pah në teorinë juridike detyrimi i organit të kujdestarisë që, me vendim për zgjidhjen e birësimit jo të plotë, të caktojë edhe detyrimin e ushqimit për të birësuarin e mitur. Të drejtën e ushqimit të detyruar i birësuarit i mitur do ta gëzonte në qoftë se plotësohen kushtet ligjore. Kushti i parë është që i birësuarit i mitur të mos ketë pasuri të veten. Dy, të mos ketë persona të cilët, sipas ligjit, janë të detyruar që ta mbajnë.

---

Disa autorë mendojnë se pas shuarjes së birësimit shuhet edhe e drejta e mbajtjes mes birësuesit dhe të birësuarit. Shih: Dr. Nerimana Traljić, dr.Suzana Bubić: vepër e cituar, faqe, 183.

<sup>18</sup> Po aty, faqe, 289.

<sup>19</sup> Po aty, faqe, 289.

Dhe, tre, që birësuesi të ketë pasuri dhe të ketë mundësi t'i japë të birësuarit ushqimin e detyruar.

Por, sipas normave të disa ligjeve të familjes, detyrimi i ushqimit mund të peshojë edhe mbi të birësuarin. Para së gjithash, me rastin e caktimit të ushqimit për birësuesin duhet të vërtetohet në është birësuesi i paaftë për punë dhe apo ka mjete të mjaftueshme për sigurimin e ushqimit, si dhe kohëzgjatja e birësimit, për arsye se këto janë kushte të domosdoshme që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për caktimin e ushqimit të detyruar për birësuesin. Kur vërtetohet se janë plotësuar kushtet e përmendura, i birësuarin ngarkohet me detyrimin e dhënies së ushqimit birësuesit. Por, me këtë rast, po ashtu duhet të plotësohen edhe kushtet të cilat kërkohen në anën e të birësuarit, si: ka apo s'ka ai pasuri të veten, e cila do t'i shërbente si burim për përmbushjen e detyrimit të dhënies së ushqimit, a është ai i moshës madhore, a është i punësuar dhe i aftë për punë, apo jo, etj.

**1.8. Anulimi i birësimit.**- Në doktrinën juridike bëhet dallimi mes shkaqeve objektive dhe subjektive të anulimit të birësimit. Anulimi objektiv ekziston në qoftë se me rastin e lidhjes së birësimit nuk plotësohen kushtet e parapara ligjore: mituria e fëmijës, vetitë personale të birësuesit, pëlqimi i personave të autorizuar, etj.<sup>20</sup> Birësimi është relativ nul nëse pëlqimi i personit të autorizuar për lidhjen e birësimit është dhënë nën kërcënim apo në lajthim.<sup>21</sup>

Ndërkaq, në nenin 198 të Ligjit për familjen të Kosovës përcaktohet se: "Gjykata mund të anulojë marrëdhëniet e birësimit në bazë të kërkesës, nëse kjo ka qenë e themeluar pa kërkesë të birësuesit, pa pëlqimin e fëmijës apo të prindit". Pastaj, ky ligj me paragrafin 2 po të nenit 198 ka paraparë edhe rastet kur kërkesa për lidhjen e birësimit është e pavlefshme, si: mungesa e pëlqimit të nevojshëm, nëse në kohën e deklaramit të kërkesës birësuesi ka qenë në gjendje të pallogaritshme (çmendurie), nëse i ka munguar zotësia e veprimit, ose fëmija që birësohet ka qenë më i ri se 14 vjet dhe pa zotësi për të vepruar, etj.

Padia për anulimin e birësimit, sipas par. 4 të nenit 198 të LFK-së, "mund të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita kur është marrë në dijeni shkaku i anulimit, e më së voni brenda 1 viti nga dita e themelimit të birësimit". Mbi anulimin e birësimit vendos gjykata kompetente,

<sup>20</sup> Marina Janjić-Komar dr Radoje Korać dr Zoran Ponjavić: vepra e cituar, faqe,248.

Kodi i familjes i Shqipërisë fare nuk e rregullon çështjen e anulimit të birësimit, veçse në dispozitën e nenit 258 ka përcaktuar se birësimi prodhon efektet e tij nga data që vendimi merr formë të prerë dhe se ai është i përvokueshëm.

<sup>21</sup> Po aty, faqe, 248.

në juridiksionin e së cilës ndodhet selia e organit të kujdestarisë para të cilit është lidhur birësimi. Janë të prekshme çastet e anulimit të birësimit, sepse fëmija duhet të ndahet nga familja e birësuesit, në të cilën ka jetuar një kohë të gjatë bashkë me anëtarët e tjerë të asaj familjeje, ndërsa duhet të vendoset në një familje të re, me anëtarët e së cilës nuk ka jetuar së bashku dhe nuk ka zhvilluar marrëdhëniet e ngrohta familjare deri me anulimin e birësimit.

**1.9. Pasojat e anulimit të birësimit.**- Me aktgjykimin mbi anulimin e birësimit gjykata, për shkaqe të arsyeshme, i cakton të birësuarit mbajtjen derisa ai të mbushë moshën madhore, ndërsa me detyrimin e dhënies së ushqimit e ngarkon birësuesin, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dy palëve.<sup>22</sup> Gjykata, po ashtu, edhe të birësuarin mund ta ngarkojë me detyrimin e dhënies së ushqimit birësuesit. Do theksuar se në nenin 201, Ligji për familjen i Kosovës mjaft hollësisht i ka rregulluar pasojat e shuarjes së birësimit. Vetëm në të ardhmen shuarja e birësimit shkakton efekte juridike. Me atë rast ndërpriten marrëdhëniet e birësimit mes birësuesit dhe të birësuarit, pastaj të birësuarit dhe pasardhësve të tij me personat në gjini të birësuesit, si dhe të drejtat dhe detyrimet të cilat burojnë nga birësimi. Këto marrëdhënie, në të njëjtën kohë, ripërtërihen mes fëmijës së birësuar dhe prindërve të tij biologjikë e personave të tjerë gjini gjaku. Po ashtu, në bazë të nenit 202 të LFK-së, "me shuarjen e birësimit fëmija humb të drejtën e mbajtjes të mbiemrit të birësuesit si mbiemër të vetin". Përfundimisht, kur gjykata gjen se është në interesin e të birësuarit, ajo mund të lejojë që ai edhe më tutje të mbajë mbiemrin e fituar me birësim.

Aktgjykimi i plotfuqishëm mbi anulimin e birësimit i dërgohet ofiqarit të gjendjes civile për ta regjistruar në regjistrat amzë të të lindurve.

---

<sup>22</sup> Po aty, faqe, 249.

LFK-Ligji për familjen i Kosovës i miratuar më 6 shtator 2004 nga Kuvendi i Kosovës  
KFSH-Kodi i Familjes i Shqipërisë.

LFM-Ligji për familjen i Maqedonisë.

## Rezyme

Në kohën e lashtë qëllimi dominues i birësimit të fëmijëve ka qenë nevoja e mbrojtjes së pasurisë së qytetarëve të pasur dhe ruajtja e vazhdimësisë së familjes, të traditës dhe të kultit të familjes së qytetarëve pa fëmijë. Tashti qëllimi kryesor i birësimit është mbrojtja me ligj e interesave të fëmijëve të mitur.

Dallojmë dy lloje të birësimit: birësimin e plotë dhe birësimin jo të plotë. Me birësim të plotë themelohen të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve, ashtu që birësuesi regjistrohet në librat amë të gjendjes civile si prind i të birësuarit. Kjo nënkupton se i birësuarit shkëput lidhjet me familjen e tij të origjinës. Në pikëpamje të drejtave dhe detyrimeve i birësuarit barazohet me persona të tjerë në gjini të birësuesit. Me birësim jo të plotë duhet kuptuar vendosjen e marrëdhënieve prindërore vetëm mes birësuesit dhe fëmijës që birësohet, si dhe pasardhësve të fëmijës, por megjithatë, ekzistojnë edhe kufizime të mundshme në pikëpamje të të drejtave përkitazi me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore. Birësimi jo i plotë është i shkëputshëm dhe fëmija ruan marrëdhëniet gjinore me familjen e origjinës.

Birësimi themelohet përpara organit të kujdestarisë, pra në rrugë juridike, me vendim. Birësues mund të jetë vetëm personi që ka mbushur 21 vjet dhe që i plotëson edhe kushtet e tjera ligjore. I birësuar mund të jetë vetëm personi i mitur. Është i domosdoshëm ndryshimi në moshë midis birësuesit dhe të birësuarit. Dallimi në moshë duhet t'i përgjigjet dallimit të natyrshëm në moshë që ekziston mes fëmijëve dhe prindërve.

